



02/Nr. 8345/2026
Data: 04.09.2026

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 14.08.2026 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 14:00 prezent ishin 12 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Arsim Dernjani.

Rendi i Punës

1. Draft plani për riintegrim dhe riatdhesim për vitin 2026-2028

Arsim Dernjani:- përmes këtij plani ofrojmë të drejta të mbrojtura dhe kushte më të mira për të gjithë personat e riatdhesuar. Në komunën kur paraqiten personat në institucionet ku përfshihen me rastin duke përfutur nga paraqitja, vizita, verifikimi dhe në fund riatdhesimi i personave. Ky plan është plan regjional dhe është bërë nga ekspertët por ne kemi bërë disa modifikime. Ky plan është edhe për performacë të komunës dhe nuk ka implikime buxhetore.

Hisni Luri:- personat të cilët po vijnë ilegalisht a bëjnë pjesë në këtë plan.

Arsim Dernjani:- jo nuk bëjnë pjesë por është baza në Magure që fillimisht lajmërohen në Polici të cilëve ju kërkojnë trajtim.

Amir Dernjani:- pasi është plan për riintegrim si mundet me ju ndihmuar pasi që është plan pa implikime buxhetore.

Arsim Dernjani:- komunat kanë shuma shumë të vogla dhe nuk mundën me i përkrahë dhe kjo është prej nivelit qendrorë. A keni edhe ndonjë diskutim apo propozim, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 14:10.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

Zyrtarë për Komunitete dhe Kthim
Arsim Dernjani

